



Hapet Thirrja për Mobilitete për staf të Fakultetit të Arkitekturës e Urbanistikës në UPT, në kuadër të Marrëveshjes KA107, të Programit Erasmus+, në Universitetin e Venezas IUAV, në Itali

Në kuadrin e marrëveshjes dy palëshe të FAU dhe Universiteti IUAV i Venezas, “An Implementation Agreement for Academic Cooperation for Setting Up a Double Degree” dhe në kuadrin e programit Erasmus+ KA 107, është hapur thirrja për aplikime për bursa, për stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, të cilët mund të kryejnë trajnim apo mësimdhënie pranë Universitetit IUAV të Venezas, në Itali.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbim stafi për mësimdhënie (mobility for teaching)
- Shkëmbim stafi mësimdhënës për trajnim (mobility for training)

Kohëzgjatja e bursave:

- **Staf për mësimdhënie:** 5 ditë + 2 ditë udhëtim
- **Staf për trajnim:** 5 ditë + 2 ditë udhëtim

Stafi do të marrë pjesë në javën “IUAV Staff Week” në datat 5-9 qershor 2023, të organizuar nga IUAV, Venezia. <https://www.iuav.it/studenti/MOBILITY/INCOMING-S/staff/>

Për të shkarkuar formatet: Staff Mobility for Training dhe Staff Mobility for Teaching, ju lutemi klikoni te: [Aneks 3](#) , [Aneks 4](#) .

Numri i Mobiliteteve:

- Numri total Staf për mësimdhënie: **1 pedagog**
- Numri total Staf për trajnim: **1 pedagog**

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Dokumenti Staff Mobility for Teaching Mobility Agreement, apo Staff Mobility for training Mobility Agreement;
- Niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B2. (Italisht ose Anglisht).

Afati për aplikim: 25 prill 2023

Dokumentacioni dorëzohet pranë Sektorit të Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.